

RL Tekstile sh.p.k

Rruga e Dibres,
Tiranë

PASQYRAT FINANCIARE

2019

Në zbatim të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit – të përmirësuara, dhe Ligjit Nr. 25/2018 Datë 10.05.2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”

Përmbajtja	Faqe
Informacion i përgjithshëm	3
Raporti i Ndërtimit të Pasqyrave Financiare	4
Pasqyra e Performancës	5
Pasqyra e pozicionit financiar	6-7
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto	8
Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare	9
Politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare	10 - 19

Miratimi i Pasqyrave Financiare

Këto pasqyra financiare u miratuan nga drejtimi i shoqërisë, u autorizuan për publikim në datë 11 Mars 2020 dhe i paraqiten për miratim Asamblesë së Ortakëve.

Ornald Hajdari
Administrator
11 Mars 2020



1. Informacion i përgjithshëm**Informacion i përgjithshëm**

Vendi	Shqipëri
Data e themelimit	26.06.2018
Data e regjistrimit	27.06.2018
Monedha Raportuese	Leku Shqiptar
Monedha Funktionale	Leku Shqiptar
Adresa e Zyrave Qendrore	Rr. "5 Maji", ish "Peliceria", Godina 1 dhe 4 Tiranë
Administratori	Ornald Hajdari
Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	L81827025E
Rajoni Tatimor	Drejtoria Tiranë
Kapitali i nënshkruar	10.000 lek
Ortakët - Pjesëmarrja në (%)	Ornald Hajdari - 40% Rajner Gore - 60%

Përshkrim i përgjithshëm i veprimtarisë:

RL Tekstile SHPK është themeluar dhe regjistruar në QKB në formën juridike të Personit Juridik dhe me emër tregtar RL TEKSTILE, në vijim Shoqëria. Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Gjatë vitit 2019 aktiviteti kryesor i zhvilluar, në përputhje edhe me objektin e saj në statut, është: "Prodhim industrial e artizanal i kepuceve, sandale etj, te cdo grup moshe e seksi me lekure te importit e te vendit. Prodhime veshjesh te ndryshme, lekure e pelicerie. Tregetim i tyre me shumice e pakice brenda e jashte vendit. Grumbullim, perpunim dhe tregetim i lekurave te ndryshme brenda e jashte vendit. Tregetim i artikujve te ndryshem industriale te fushes se ndertimit, hidrosanitare dhe te fushes bujqesore me shumice e pakice."

RAPORTI I NDËRTIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE**Drejtimit të shoqërisë RL Tekstile sh.p.k**

Ne kemi përgatitur Pasqyrat Financiare të RL Tekstile sh.p.k bazuar në informacion që ju na keni dhënë. Këto Pasqyra Financiare janë paraqitur në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Pasqyrat Financiare përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2019 dhe pasqyrën e performancës që përbëhet nga një pasqyrë e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe një pasqyrë e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të Pasqyrave Financiare, duke përfshirë këtu miratimin e kuadrit të përgjithshëm të zbatueshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, si dhe për saktësinë dhe plotësinë e informacionit që ne kemi përdorur për të hartuar këto Pasqyra Financiare.

Ne e kryem angazhimin tonë për hartimin e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me ligjin Nr. 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe Standartin Ndërkombëtar për Shërbimet e lidhura 4410, i rishikuar. Ky Standart kërkon që ne, gjatë procesit të përgatitjes, të përmbushim përgjegjësitë tona në lidhje me standartet e kontrollit të cilësisë si dhe kërkesat etike të aplikueshme, të cilat ndër të tjera përfshijnë edhe parimet themelore etike të integritetit, objektivitetit, konfidencialitetit, sjelljes profesionale, kompetencës profesionale dhe kujdesit të duhur.

Një marrëveshje angazhimi për hartimin e pasqyrave financiare përfshin aplikimin e ekspertizës në mbajtjen e kontabilitetit dhe raportimit financiar, me qëllim që të ndihmojë drejtimin e shoqërisë në përgatitjen dhe paraqitjen e informacionit financiar. Një angazhim i tillë nuk përfshin mbledhjen e evidencës për qëllime të shprehjes së një opiniononi auditimi apo të një konkluzioni rishikues. Në këtë mënyrë, ne nuk shprehim një opinion auditimi apo një konkluzion rishikimi në lidhje me këto pasqyra financiare.



Ekonomisti

Tiranë

11 Mars 2020

Pasqyrat Financiare¹

1. Pasqyra e Performancës (sipas natyrës)

	Shen	16.05.2019 - 31.12.2019	01.01.2019 - 15.05.2019	Viti 2019	Viti 2018
Te ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit					
<i>Te ardhurat nga aktiviteti kryesor</i>	2	18,627,472	7,979,857	26,607,329	3,205,348
<i>Te ardhurat nga aktiviteti dytesor 1</i>		0	0	0	0
<i>Te ardhurat nga aktiviteti dytesor 2</i>		0	0	0	0
<i>Te ardhurat nga aktiviteti dytesor 3</i>		0	0	0	0
<i>Te tjera te ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit</i>		0	0	0	0
Te ardhura nga ndryshimi ne inventarin e mallrave dhe prodhimet ne proces		0	0	0	0
Te ardhura nga puna e kryer nga njesia ekonomike per qellimet e veta dhe e kapitalizuar		0	0	0	0
Te ardhura te tjera te shfrytëzimit		0	0	0	0
Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme					
<i>Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme</i>	3	(799,253)	(330,260)	(1,129,513)	(289,252)
<i>Te tjera shpenzime</i>		0	0	0	0
Shpenzime te personelit					
<i>Paga dhe shperblime</i>	4	(21,408,994)	(9,461,337)	(30,870,331)	(6,026,769)
<i>Shpenzime te sigurimeve shoqerore/shendetesore</i>	4	(3,571,311)	(1,553,515)	(5,124,826)	(1,029,630)
<i>Shpenzimet per pensionet</i>		0	0	0	0
Zhvleresimi i aktiveve afatgjata materiale					
<i>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</i>	12	(948,901)	(4,202)	(953,103)	(306,313)
Shpenzime te tjera shfrytëzimi	5	(8,081,319)	(3,108,086)	(11,189,405)	(1,841,525)
Te ardhura te tjera					
<i>Te ardhura nga njesite ekonomike ku ka interese pjesmarrese</i>		0	0	0	0
<i>Te ardhura nga investimet dhe huatë e tjera ne njesi ekonomike ku ka interese pjesmarrese, pjese e aktiveve afatgjata</i>		0	0	0	0
<i>Interesa te arketueshem dhe te ardhura te tjera te ngjashme nga njesi ekonomike ku ka interese pjesmarrese</i>		0	0	0	0
Zhvleresim i aktiveve financiare dhe investimeve financiare te mbajtura si aktive afatshkurtra		0	0	0	0
Shpenzime financiare					
<i>Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme</i>	6	(145,102)	0	(145,102)	0
<i>Shpenzime te tjera financiare</i>	6	87,122	20,143	107,265	102,865
Pjesa e fitimit/(humbjes) financiare nga pjesmarrjet		0	0	0	0
Fitimi/(humbja) para tatimit		(16,240,286)	(6,457,400)	(22,697,686)	(6,185,276)
Tatimi mbi fitimin					
<i>Tatimi mbi fitimin e periudhes</i>	7	0	0	0	0
<i>Tatim fitimi i shtyre</i>		0	0	0	0
<i>Pjesa e tatim fitimit te pjesemarrjeve</i>		0	0	0	0
Fitimi/(Humbja) e periudhes/vitit (A)		(16,240,286)	(6,457,400)	(22,697,686)	(6,185,276)
Te ardhura te tjera gjithëpërfshirese per periudhen/vitin:					
<i>Diferenca (+/-) nga perktimi i monedhes ne veprimtari te huaja</i>					
<i>Diferenca (+/-) nga rivleresimi i aktiveve afatgjata materiale</i>					
<i>Diferenca (+/-) nga rivleresimi i aktiveve financiare te mbajtura per shitje</i>					
<i>Pjesa e te ardhurave gjithëpërfshirese nga pjesmarrjet</i>					
Totali i te ardhurave te tjera gjithëpërfshirese per periudhen/vitin (B)		0	0	0	0
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirese per periudhen/vitin (A+B)		(16,240,286)	(6,457,400)	(22,697,686)	(6,185,276)

¹ Pasqyrat Financiare janë të lexueshme bashkë me shënimet shpjeguese 2-17

2. Pasqyra e pozicionit financiar (Balanci)

	Shen	2019	2018
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	8	3,462	2,558,267
Investime			
<i>Ne tituj pronesia te njesive ekonomike brenda grupit *</i>		0	0
<i>Ne tituj pronesia te njesive ekonomike ku ka interesa pjesmarrese aksione te veta</i>		0	0
<i>Te tjera financiare</i>		0	0
Te drejta te arketueshme			
<i>Nga aktiviteti i shfrytezimit</i>	9	1,196,891	788,171
<i>Nga njesite ekonomike brenda grupit *</i>		0	0
<i>Nga njesite ekonomike ku ka interesa pjesmarrese</i>		0	0
<i>Te tjera</i>	10	2,010,818	443,810
<i>Kapital i nenshkruar i papaguar</i>		0	10,000
Inventaret			
<i>Lende e pare dhe materiale te konsumueshme</i>		0	0
<i>Prodhime ne proces dhe gjysemprodukte</i>		0	0
<i>Produkte te gatshme</i>		0	0
<i>Mallra</i>		0	0
<i>Aktive biologjike (gje e gjalle ne rritje dhe majmeri)</i>		0	0
<i>AAGJM te mbajtura per shitje</i>		0	0
<i>Parapagime per inventar</i>		0	0
Shpenzime te shtyra	11	91,208	91,208
Te arketueshme nga te ardhura te konstatuara		0	0
Totali i aktiveve afatshkurtra		3,302,378	3,891,455
Aktive afatgjate			
Aktive financiare			
<i>Tituj pronesia te njesive ekonomike brenda grupit *</i>		0	0
<i>Tituj pronesia te njesive ekonomike ku ka interesa pjesmarrese</i>		0	0
<i>Tituj te huadhenies ne njesite ekonomike brenda grupit *</i>		0	0
<i>Tituj te huadhenies ne njesite ekonomike ku ka interesa pjesmarrese</i>		0	0
<i>Tituj te tjere te mbajtur si aktive afatgjate</i>		0	0
<i>Tituj te tjere te huadhenies</i>		0	0
Aktive materiale			
<i>Toka dhe ndertesa</i>		0	0
<i>Impiante dhe makineri</i>	12	5,680,287	4,287,511
<i>Te tjera instalime dhe pajisje</i>	12	34,668	43,335
<i>AAGJM te mbajtura per investim</i>		0	0
<i>Parapagime per aktive materiale dhe ne proces</i>		0	0
Aktivitet biologjike		0	0
Aktive jo materiale			
<i>Koncensione, patenta, licensa, makra tregtare, te drejta dhe aktive te ngjashme</i>		0	0
<i>Emri i mire</i>		0	0
<i>Parapagime per AAJM</i>		0	0
Aktivitet tatimore te shtyra		0	0
Totali i aktiveve afatgjate		5,714,955	4,330,846
TOTALI I AKTIVEVE		9,017,333	8,222,301

2. Pasqyra e pozicionit financiar (Balanci)

DETYRIMET DHE KAPITALI	Shen	2019	2018
Detyrime afatshkurtra			
<i>Titujt e huamarjes</i>	13	14,981,282	0
<i>Detyrime ndaj institucioneve te kredise</i>		0	0
<i>Aktetime ne avance per porosi</i>		0	0
<i>Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit</i>	14	819,596	117,976
<i>Deftesa te pagueshme</i>		0	0
<i>Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit *</i>		0	0
<i>Te pagueshme ndaj njesive ekonomike ku ka interesa pjesmarrese</i>		0	0
<i>Te pagueshme ndaj pimonjesve dhe sigurimeve shoqerore/shendetsore</i>	15	3,619,416	2,099,964
<i>Te pagueshme per detyrime tatimore</i>	16	177,623	76,341
<i>Te tjera te pagueshme</i>	17	18,292,377	12,103,296
Te pagueshme per shpenzime te konstatuara		0	0
Te ardhura te shtyra		0	0
Provizione		0	0
Totali i detyrimeve afatshkurtra		37,890,294	14,397,576
Detyrime afatgjata			
<i>Titujt e huamarjes</i>		0	0
<i>Detyrime ndaj institucioneve te kredise</i>		0	0
<i>Aktetime ne avance per porosi</i>		0	0
<i>Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit</i>		0	0
<i>Deftesa te pagueshme</i>		0	0
<i>Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit *</i>		0	0
<i>Te pagueshme ndaj njesive ekonomike ku ka interesa pjesmarrese</i>		0	0
<i>Te tjera te pagueshme</i>		0	0
Te pagueshme per shpenzime te konstatuara		0	0
Te ardhura te shtyra		0	0
Provizione			
<i>Provizione per pensione</i>		0	0
<i>Provizione te tjera</i>		0	0
Detyrime tatimore te shtyra		0	0
Totali i detyrimeve afatgjata		0	0
Detyrime totale		37,890,294	14,397,576
Kapitali dhe Rezervat			
Kapitali i nenshkuar	18	10,000	10,000
Primi i lidhur me kapitalin		0	0
Rezerva rivleresimi		0	0
Rezerva te tjera			
<i>Rezerva ligjore</i>		0	0
<i>Rezerva statutore</i>		0	0
<i>Rezerva te tjera</i>		0	0
<i>Diferenca nga perkthimi i monedhes ne veprimtari te huaja</i>		0	0
Fitimi/(humbja) e pashperndare	18	(6,185,275)	0
Fitimi/(humbja) e periudhes	18	(22,697,686)	(6,185,276)
Totali i kapitalit qe i takon pronareve njesise ekonomike		(28,872,962)	(6,175,276)
Interesa jo-kontrollues		0	0
Totali i kapitalit		(28,872,962)	(6,175,276)
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		9,017,333	8,222,301

3. Pasqyra e levizjeve ne kapitalin neto

	Kapitali i nenshkuar	Rezerva te tjera	Fitimet/ (humbjet) e pashperndara	Fitim/(humbja) e periudhes	Totali
Pozicioni financiar ne fillim 2018	0	0	0	0	0
Efekti i ndryshimeve ne politikat kontabile					0
Pozicioni financiar i rideklaruar ne fillim 2018	0	0	0	0	0
Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse te periudhes:					0
Fitim/(humbja) e periudhes				(6,185,276)	(6,185,276)
Te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse					0
Tatime aktuale dhe te shtyra te njohura drejtperdrejt ne kapital					0
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse per periudhen	0	0	0	(6,185,276)	(6,185,276)
Transaksione per pronaret e njësisë ekonomike te njohura direkt ne kapital:					0
Emetim i kapitalit të nënshkuar	10,000				10,000
Dividende te shpendare					0
Percaktime te tjera per rezultatin e periudhes (pershkruaj)		0			0
Totali i transaksioneve per pronaret e njësisë ekonomike	10,000	0	0	0	10,000
Pozicioni financiar ne fund (viti paraardhes) 2018	10,000	0	0	(6,185,276)	(6,175,276)
					0
Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse te periudhes:					0
Fitim/(humbja) e periudhes				(22,697,686)	(22,697,686)
Te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse					0
Tatime aktuale dhe te shtyra te njohura drejtperdrejt ne kapital					0
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse per periudhen	0	0	0	(22,697,686)	(22,697,686)
Transaksione per pronaret e njësisë ekonomike te njohura direkt ne kapital:					0
Emetim i kapitalit të nënshkuar					0
Dividende te shpendare		0			0
Percaktime te tjera per rezultatin e periudhes (pershkruaj)			(6,185,276)	6,185,276	0
Totali i transaksioneve per pronaret e njësisë ekonomike	0	0	(6,185,276)	6,185,276	0
Pozicioni financiar ne fund (viti aktual) 2019	10,000	0	(6,185,276)	(22,697,686)	(28,872,962)

4. Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetar (metoda indirekte)

	<u>Shën</u>	<u>2019</u>	<u>2018</u>
Fluksi mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit:			
Fitimi/(Humbja) e periudhes		(22,697,686)	(6,185,275)
<i>Rregullime per shpenzimet jo-monetare:</i>			
Shpenzimet financiare jomonetare			
Shpenzime per tatimin mbi fitimin jo-monetar (diferenca shpenzim - pagese gjate periudhes)			
Shpenzime konsumi dhe amortizimi		953,103	306,313
Fluksi i mjeteve monetare i perfshire ne aktivite investuese			
(Fitim)/humbja nga shitja e aktiveve afatgjata materiale			
(Fitim)/humbja nga investimet ne pjesmarje			
Interesa te fituara			
Ndryshim ne aktivet dhe detyrimet e shfrytezimit			
Renie/(Rritje) ne te drejtat e arketueshme dhe te tjera		(1,965,728)	(1,333,188)
Renie/(Rritje) ne inventar		0	0
Rritje/(Renie) ne detyrime te pagueshme		802,903	194,316
Rritje/(Renie) ne detyrime per punonjesit		1,519,452	2,099,964
Te tjera (<i>pershkruaj</i>)			
Mjete monetare neto nga/ perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit		(21,387,957)	(4,917,870)
Fluksi i mjeteve monetare nga/ perdorur ne aktivitetin e investimit			
Pagesa per blerjen e aktiveve afatgjata materiale		(2,337,212)	(4,637,159)
Arketime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale			
Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e investimit		(2,337,212)	(4,637,159)
Fluksi i mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e financimit			
Arketime nga emetimi i kapitalit te nenshkruar		0	10,000
Arketime nga emetimi i aksioneve te perdorura si kolateral			
Hua te arketuara		21,170,363	12,103,296
Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e financimit		21,170,363	12,113,296
Rritje/(renie) neto ne mjetet monetare dhe ekuivalente me to		(2,554,805)	2,558,267
Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fillim		2,558,267	
Efekt i luhatjeve te kurseve te kembimit te mjeteve monetare			
Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fund		3,462	2,558,267

Shënimet Shpjeguese

1. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël

- **Deklarata e Pajtueshmërisë me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në zbatim të Ligjit nr 25/2018, date 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara 1-14 (SKK) të publikuara bazuar në urdhërin e Ministrit të Financave nr 64 datë 22.07.2014 “Për Shpalljen e Standardeve Kombëtare Kontabël dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”.

Pasqyrat Financiare janë në pajtueshmëri të plotë me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

- **Parimet bazë për përgatitjen e Pasqyrave Financiare**

Shoqëria ka përgatitur Pasqyrat Financiare duke respektuar kërkesat e SKK 1 dhe të Ligjit të Kontabilitetit “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” ku përcaktohen parimet-bazë për mbajtjen e kontabilitetit dhe përgatitjen e pasqyrave financiare, për të cilat në vijim jepen shkurtimisht shpjegime. Asnjë nga këto parime nuk ka përparësi ndaj ndonjë kërkesë specifike të SKK 1 ose ndonjë SKK-je tjetër.

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi *bazën e konceptit të materialitetit* që nënkupton dhënien rëndësi atyre aspekteve dhe të dhënave financiare të veprimtarive ekonomike që janë të rëndësishme për përdoruesit e pasqyrave financiare, e që mund të ndikojnë në vendimet ekonomike që ata marrin, dhe mbi bazën e parimit të kostos historike.

Pasqyrat financiare paraqesin të gjithë informacionin material që ndikon në pozicionin financiar, performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare të shoqërisë. *Informacioni në këto pasqyra konsiderohet material, nëse mungesa ose pasaktësia në paraqitjen e tij do të ndikonte në vendimet ekonomike të përdoruesve të pasqyrave financiare.*

Në përcaktimin e materialitetit janë marrë parasysh aspektet cilësore dhe sasiore të informacionit, që nënkupton se për transaksione të caktuara në shumën të vogla ku ka një rëndësi kuptimore më të madhe se sa transaksione të tjera të zakonshme, ato janë paraqitur veçmas. Zërat jomaterialë janë raportuar në pasqyrat financiare të grupuara me zëra të tjerë jomaterialë të ngjashëm.

Konstatimi i të drejtave / detyrimeve dhe përputhshmëria - Me qëllim që të përmbushin objektivat e tyre, pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Sipas kësaj metode, efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve njihen në pasqyrat financiare kur ato ndodhin (dhe jo kur paraja/ekuivalentet e saj arkëtohen/paguhen) si dhe njihen në kontabilitet e raportohen në pasqyrat financiare të periudhave kontabël të cilave u përkasin. Pasqyrat financiare, të përgatitura në bazë të kësaj metode, i informojnë përdoruesit jo vetëm mbi transaksionet e shkuara të shoqëruara me arkëtime dhe pagesa, por edhe mbi detyrimet për t’u paguar në të

ardhmen si dhe mbi aktive që do të sjellin arkëtime në të ardhmen. Në këtë mënyrë, ato paraqesin informacione të cilat u shërbejnë përdoruesve më së miri në marrjen e vendimeve ekonomike.

Parimi i vijimësisë - Pasqyrat financiare janë përgatitur sipas parimit të vijimësisë, që do të thotë se veprimtaria ekonomike e shoqërisë do të ketë vijimësi dhe se shoqëria nuk ka në plan ose nuk do ta ketë të nevojshme ta ndërpresë aktivitetin e saj dhe pret që edhe për periudhën pasardhëse 12 mujore të jetë në vijimësi të plotë të veprimtarisë së saj.

Parimi i kompensimit - Aktivet / detyrimet dhe të ardhurat / shpenzimet nuk kompensohen me njëra-tjetrën, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë kërkohet ose lejohet nga një SKK. Shoqëria ka ndërtuar Pasqyrat Financiare duke e zbatuar plotësisht këtë parim.

Njohja, Matja fillestare dhe vlerësimi i mëpasshëm i një zëri që plotëson përkufizimin e një aktivi, detyrimi, të ardhure ose shpenzimi në pasqyrat financiare bëhet në përputhje me kërkesat specifike të SKK-ve përkatëse, të cilat më hollësisht shpjegohen si vijon.

- **Politika të tjera kontabël, të rëndësishme për kuptimin e pasqyrave financiare**
- **Monedha e paraqitjes së pasqyrave financiare**

Monedha e paraqitjes së pasqyrave financiare është në LEKË.

Në datë 31 Dhjetor 2019 zërat monetarë të shprehur në monedhë të huaj janë përkthyer duke përdorur kursin e këmbimit të datës së mbylljes së këtyre pasyrave si në tabelë:

Kursi i këmbimit	2019	2018
Monedha:		
EURO	121.77	123.42

Transaksionet jomonetarë në monedhë të huaj të ndodhur gjatë vitit janë përkthyer duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

- **Instrumentet financiare**

Shoqëria ka njohur aktiv financiar dhe detyrim financiar, duke i matur ato fillimisht me kostot e transaksionit (duke përfshirë edhe çmimin e transaksionit).

Shoqëria për vitin 2019 ka njohur si *aktive financiare*, Llogari të Arkëtueshme për mallrat dhe shërbimet e shitura klientëve të saj me kredi afatshkurtër, me vlerën e paskontuar të mjeteve monetare të arkëtueshme që pret të arkëtojë në të ardhmen, që është normalisht çmimi i faturës. Në datën e ndërtimit të këtyre PF ka vlerësuar këto llogari të arkëtueshme me koston e amortizuar të tyre, e cila është shuma e vlerave: a) vlera fillestare e aktivit financiar; (b) minus çdo pagesë principali; (c) minus çdo pakësim (direkt ose përmes përdorimit të llogarisë së zhvlerësimit) për zhvlerësimin apo pambledhshmërinë. Në fund të kësaj periudhe raportimi, shoqëria ka vlerësuar se nuk ka një evidencë objektive të zhvlerësimit të ndonjë aktivi financiar që matet me koston e

amortizuar dhe si rezultat nuk ka llogaritur zhlerësim të klientëve të saj dhe llogarive të tjera të arkëtueshme.

Shoqëria për vitin 2019 ka njohur si *detyrime financiare*, Llogari të Pagueshme për mallrat, produktet e shërbimet e blera nga furnizuesët e saj me kredi afatshkurtër, me shumën e paskontuar që i detyrohet furnizuesit, dhe që është zakonisht çmimi i faturës. Në datën e ndërtimit të këtyre PF ka vlerësuar këto llogari të pagueshme me koston e amortizuar të tyre, e cila është shumta e vlerave: a) vlera fillestare e detyrimit financiar; (b) minus çdo pagesë principlali. Në fund të kësaj periudhe raportimi, shoqëria nuk ndodhet në kushtet kur duhet të ç'regjistrojë një detyrim financiar si pasojë e anulimit apo skadimit të tij.

o **Inventarët**

Matja fillestare e inventarëve bëhet me kosto, e cila përfshin të gjitha shpenzimet e blerjes dhe shpenzimet e tjera që shërbejnë për të sjellë inventarët në vendin dhe në gjendje përdorimi (si p.sh shpenzimet e transportit, të magazinimit, taksat e parimbursueshme).

Në pasqyrën e pozicionit financiar inventarët paraqiten (maten) me vlerën më të ulët midis kostos dhe çmimit të vlerësuar të shitjes pakësuar me kostot për t'u përfunduar dhe shitur.

Gjatë vitit ushtrimor shoqëria ka zhvilluar aktivitet me inventarë, por nuk ka gjendje në fund viti.

o **Aktivet Afatgjata**

Matja fillestare e aktiveve afatgjata që plotësojnë kriteret për njohje si aktiv bëhet **me kosto**, e cila përfshin: (a) koston e blerjes (përfshirë taksat e parimbursueshme, zbritur skontot tregtare); (b) kosto të tjera të drejtpërdrejta që lidhen me sjelljen e aktivit në vendndodhjen dhe kushtet e nevojshme për funksionimin e tij (shpenzime transporti, kostot e përgatitjes së terrenit, lëvizimin dhe trajtimin fillestar, instalimin dhe montimin, si dhe testimin e tij). Në pasqyrën e pozicionit financiar, aktivet afatgjata materiale ose jomateriale, janë paraqitur sipas Modelit të Kostos, e cila është kosto fillestare minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Kostot që kanë të bëjnë me përmirësimet e mëpasshme i shtohen kostos së AAM-së vetëm nëse ato përmbushin kriteret e përkufizimit të AAM-së dhe kriteret për njohjen e aktiveve. Kostot që lidhen me mirëmbajtjet dhe riparimet e vazhdueshme njihen si shpenzime gjatë vitit ushtrimor.

Vlera e aktiveve të marra me qira pasqyrohet në pasqyrën e pozicionit financiar të qiramarrësit, si aktiv dhe si detyrim vetëm nëse plotësohen kriteret e SKK 7, në të kundërt ato njihen si shpenzime qiraje të zakonshme në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Për vitin ushtrimor të mbyllur shoqëria zotëron vetëm aktive afatgjata materiale (AAM).

Vlera e amortizueshme e një aktivi njihet sistematikisht në shpenzime në ushtrimet vjetore përkatëse bazuar në jetën e tyre të dobishme, duke marrë parasysh (a) përdorimin e pritshëm të aktivit, (b) konsumimin fizik të pritshëm, (c) vjetërimin teknik/tregtar, (d) kufizimet ligjore apo të ngjashme për përdorimin e aktiveve (datat e skadimit). Metoda e përdorur për llogaritjen e amortizimit të periudhës ushtrimore është metoda e vlerës së mbetur. Toka normalisht ka një jetëgjatësi pa afat, prandaj nuk amortizohet. Normat e aplikuara nga shoqëria në llogaritjen e amortizimit për AAM për vitin ushtrimor janë si më poshtë:

Grupim Zëri AA	Norma amortizimit (%)	Metoda
Makineri, pajisje, instrumente dhe vegla pune	20	Vlerë e mbetur
Mobilje dhe pajisje zyre	20	Vlerë e mbetur
Pajisje informatike	25	Vlerë e mbetur

o **Detyrimet**

Shoqëria i ka paraqitur detyrimet në pasqyrën e pozicionit financiar, sipas kërkesave të SKK 2, duke i klasifikuar si detyrime aftashkurta kur: a) pret ta shlyejë detyrimin brenda ciklit normal të shfrytëzimit; (b) e mban detyrimin kryesisht për qëllime tregtimi; (c) detyrimi do të shlyhet brenda 12 muajve pas datës së raportimit; ose (d) shoqëria nuk ka një të drejtë të pakushtëzuar për të evituar shlyerjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së raportimit. Të gjitha detyrimet e tjera klasifikohen si detyrime afatgjata.

Për vitin ushtrimor shoqëria ka vetëm detyrime aftashkurta dhe asnjë detyrim afatgjatë.

o **Të ardhurat dhe shpenzimet**

Të Ardhurat janë përfitimet ekonomike bruto, të marra gjatë periudhës kontabël, si rezultat i rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike, që çojnë në rritjen e kapitalit.

Njohja e të ardhurave ndodh atëherë kur është e mundur se do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme, e cila përfshin shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë. Të ardhurat nga shitjet e mallrave dhe e produkteve njihen në momentin e transferimit të rreziqeve dhe të përfitimeve që vijnë nga pronësia mbi mallrat dhe produktet e shitura tek blerësit. Të ardhurat nga shërbimet njihen në masën e shërbimeve të kryera, me metodën e fazës së kryer të shërbimit. Të ardhurat janë njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve pavarësisht nëse janë faturuar apo paguar. Shoqëria realizon të ardhura nga shitjet e shërbimeve të kryera.

Shpenzimet përfaqësojnë flukse dalëse (pakësimet e përfitimeve ekonomike) gjatë periudhës kontabël që rezultojnë në pakësimin e aktiveve ose rritjen e detyrimeve.

Shpenzimet që lidhen me të ardhurat e fituara gjatë periudhës raportuese njihen në të njëjtën periudhë kontabël si dhe të ardhurat përkatëse pavarësisht nëse ato janë faturuar apo paguar. Shpenzimet e kryera gjatë një periudhe raportuese, që ndryshon nga periudha kur ato i sjellin përfitime shoqërisë, regjistrohen si shpenzime pikërisht në periudhën kur merren përfitimet. Nëse të ardhurat që lidhen me shpenzime të caktuara nuk mund të përcaktohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, atëherë për njohjen e tyre do të përdoren mënyra të tërthorta. P.sh shpenzimet që lidhen me blerjen e një AAM njihen si shpenzime gjatë jetës së dobishme të AAM (shpenzimet e amortizimit). Shpenzimet, që nuk priten të gjenerojnë të ardhura, njihen si shpenzime në momentin kur ato ndodhin.

o **Tatimi mbi fitimin**

Shoqëria është subjekt i Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin bazuar në ligjin Ligj Nr. 9632, date 30.10.2006 i ndryshuar. Bazuar në qarkullimin vjetor të realizuar shoqëria i është nënshtruar shkallës tatimore prej 5% (pesë) mbi fitimin e tatueshëm për periudhën deri në datë 15.05.2019. Nga data 16.05.2019 dhe deri në fund të vitit 2019 shoqëria ka kaluar në përgjegjësinë tatimor të Tatimit mbi Fitimin, duke iu nënshtruar normës tatimore prej 15%. Një shpjegim për llogaritjen e këtij fitimi në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve si dhe për zërat e pasqyrës së pozicionit financiar jepen si në vijim.

2. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

RL TEKSTILE SHPK ka ndërtuar pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas natyrës. Shitjet e realizuara gjatë vitit 2019 janë shitje shërbimeve të ndryshme të realizuara gjatë vitit, nga punimet per nënkontraktorë të punëve të fason.

	2019	2018
Të ardhura nga shitja e shërbimeve	26,607,329	3,205,348
	<u>26,607,329</u>	<u>3,205,348</u>

3. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

RL TEKSTILE SHPK ka ndërtuar pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas natyrës, dhe në këtë shënim sqaron koston e mrave/shërbimeve të tjera të cilat janë përdorur në funksion të zhvillimit normal të aktivitetit. Ato janë klasifikuar në zërin “Të tjera Shpenzime” pasi janë kryesisht materiale të konsumueshme, kancelari, dhe energji elektrike.

	2019	2018
Shpenzime për materiale të ndryshme	410,266	174,879
Shpenzime për energji elektrike	658,201	101,473
Shpenzime për ujë	48,463	0
Shpenzime blerje kancelari, aksesore dhe të ngjashme	12,582	12,900
	<u>1,129,513</u>	<u>289,252</u>

4. Shpenzime të personelit

Paraqet shumën e shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetsore të ndodhura gjatë vitit 2019. Në 31 Dhjetor shoqëria ka 93 (në 2018 61) punonjës.

	2019	2018
Shpenzime Paga	30,870,331	6,026,769
Shpenzimet e sigurimeve shoqërore e shëndetsore	5,124,826	1,029,630
	<u>35,995,157</u>	<u>7,056,399</u>

5. Shpenzime të tjera shfrytëzimi

Në këtë zë paraqitet kosto e shërbimeve kryesore dhe ndihmëse, si dhe për qëllime administrative të blera në funksion të zhvillimit normal të aktivitetit. Gjithashtu, përfshihen dhe kostot që ndodhin jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të biznesit. Një detajim i këtij zëri jepet si më poshtë:

	2019	2018
Qira	4,062,943	548,188
Shpenzime ruajtje, mirëmbajtje, riparime	268,040	10,500
Shërbime nga të tretët	136,150	27,078
Shpenzime Transporti	214,715	32,325
Shërbime konsulence teknike dhe të ngjashme	2,482,853	278,235
Shpenzime interneti dhe postare	53,815	7,900
Taksa dhe tarifa vendore	34,864	4,375
Taksa doganore	45,478	13,034
Shpenzime komisione bankare	138,455	37,897
Shpenzime të tjera korente	3,752,092	881,993
	<u>11,189,405</u>	<u>1,841,525</u>

Shërbimet nga të tretët paraqesin shërbime për konsulencë ekonomike, ligjore, konsulencë, si dhe shërbime të tjera të ndryshme, si p.sh doganore etj.

Shpenzimet e tjera korente përfaqësojnë shpenzime të përditshme aktiviteti. Shpenzimet për Udhëtime / Dieta, dhe transferime janë shpenzime të kryera gjatë vitit ushtrimor për punonjësit e dërguar për trajnim pranë klientëve jashtë Shqipërisë.

6. Të ardhura të tjera financiare

Në këtë zë paraqiten të ardhurat financiare, të realizuara nga interesat, dhe diferencat nga këmbimet dhe përkthimet valutore në rastin kur ato rezultojnë pozitive (me fitim) pasi u janë zbritur humbjet e kurseve të këmbimit, ndërsa në rastin kur ky krahasim del negativ (me humbje) paraqitet në zërin e shpenzimeve financiare. Në vitin 2019 ky krahasim ka rezultuar me fitim neto dhe është paraqitur në zërin e të ardhurave financiare. Një detajim sipas llojit jepet si në tabelë:

	2019	2018
<i>Fitimi Neto nga kursi i këmbimit</i>		
Fitim nga këmbimet dhe përkthimet valutore	174,972	178,098
Fitim nga azhurnimi i Arkës/Bankës	45,934	0
Humbje nga këmbimet dhe përkthimet valutore	(94,029)	0
Humbje nga azhurnimi i Arkës/Bankës	(19,612)	(75,232)
	0	
<i>Të tjera financiare</i>	0	-
	<u>107,265</u>	<u>102,865</u>

7. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Paraqet shumën e shpenzimit të tatimit mbi fitimin, si dhe mënyrën e llogaritjes së tij, duke bërë dhe rregullimet e nevojshme fiskale sipas legjislacionit tatimor në RSH. Sic dhe u përmend më sipër shoqëria është subjekt i shkës tatimore prej 5% për periudhën deri në datë 15.05.2019. Nga data 16.05.2019 dhe deri në fund të vitit 2019 shoqëria ka kaluar në përgjegjësinë tatimor të Tatimit mbi Fitimin, duke iu nënshtuar normës tatimore prej 15%. Për vitin 2019 shoqëria ka rezultuar me humbje fiskale llogaritja e së cilës jepet si vijon:

	<u>16.05.2019</u> <u>- 31.12.2019</u>	<u>01.01.2019</u> <u>- 15.05.2019</u>	2018
<i>Fitimi (humbja) kontabël</i>	(16,240,286)	(6,457,400)	(6,185,276)
<i>Shpenzime të panjohura fiskale</i>			
Gjoha dhe penalitete	0	0	5,000
Shpenzime të ndryshme të panjohura	2,185,442	1,557,577	876,993
	<u>2,185,442</u>	<u>1,557,577</u>	<u>881,993</u>
Humbje e mbartur nga Viti		<u>(5,303,283)</u>	
Fitimi (humbja) i (e) Tatueshme Fiskale	<u>(14,054,845)</u>	<u>(10,203,106)</u>	<u>(5,303,283)</u>
Shka tatimore aktuale e tatimit	15%	5%	5%
Shpenzimi i tatimit aktual mbi fitimin	<u>0</u>	<u>0</u>	<u>0</u>

8. Mjete monetare

Mjetet monetare në datë 31.12.2019 paraqiten:

	2019	2018
Mjete monetare në bankë	3,461	2,558,267
Mjete monetare në arkë	0	0
	<u>3,461</u>	<u>2,558,267</u>

9. Të drejta të arkëtueshme - Nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të drejtat për arkëtim ndaj klientëve të saj në datën 31.12.2019 shoqëria i ka si vijon:

	2019	2018
Klientë për mra, produkte e shërbime	1,196,891	788,171
	<u>1,196,891</u>	<u>788,171</u>

10. Të drejta të arkëtueshme - Të tjera

Të drejta e tjera të arkëtueshme paraqesin shumën e TVSH-së së zbritshme në datë 31.12.2019, dhe garanci të paguara për kontratën e qirasë.

	2019	2018
Të drejta ndaj Shtetit – TVSH	1,892,318	439,266
Të drejta ndaj Shtetit - Te tjera	0	4,543
Të drejta ndaj Shtetit - Tatim Fitim	118,500	0
	<u>2,010,818</u>	<u>443,810</u>

11. Shpenzime të shtyra

Shpenzimet e shtyra përbëhen nga shpenzime të bëra për lidhjen e kontratës me OSHEE për energji elektrike, të cilat shpërndahen në përputhje me afatin e qirasë.

12. Aktivet afatgjata materiale

Lëvizjet e aktiveve afatgjata materiale dhe e amortizimit të tyre të akumuluar gjatë vitit paraqiten si në tabelë. Për amortizimin e tyre shoqëria ka përdorur normat siç shpjegohet në politikat e tjera të rëndësishme pak më sipër. Në datën e ndërtimit të këtyre pasqyrave financiare aktvet afatgjata materiale paraqiten:

Kosto Historike	01 Janar 2019	Shtesa	Pakesime	31 Dhjetor 2019
Toka dhe Ndërtesa	0	0	0	0
Makineri dhe Pajisje	4,593,076	2,337,212	0	6,930,288
Të tjera në shfrytëzim	44,083	0	0	44,083
Totali	<u>4,637,159</u>	<u>2,337,212</u>	<u>0</u>	<u>6,974,371</u>

Amortizimi i akumuluar	01 Janar 2019	Shtesa	Pakesime	31 Dhjetor 2019
Toka dhe Ndërtesa	0	0	0	0
Makineri dhe Pajisje	305,564	944,436	0	1,250,000
Të tjera në shfrytëzim	749	8,667	0	9,416
Totali	<u>306,313</u>	<u>953,103</u>	<u>0</u>	<u>1,259,416</u>

Vlera Kontabel Neto	<u>4,330,846</u>	<u>5,714,955</u>
----------------------------	------------------	------------------

13. Titujt e huamarrjes

Paraqet shumën e huamarrjes që shoqëria ka marrë gjatë vitit 2019, për nevoja të financimit të saj, sipas kontratës së huasë.

14. Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit

Paraqet shumën e detyrimeve të papaguara në 31.12.2019 ndaj furnizuesve kryesore.

	2019	2018
Detyrime ndaj furnitorëve	819,596	117,976
	<u>819,596</u>	<u>117,976</u>

15. Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore

Paraqet shumën e detyrimeve të papaguara në 31.12.2019 ndaj punonjësve dhe ndaj shtetit për Sigurimet Shoqërore e Shëndetsore . Këto detyrime janë paguar në vitin 2020.

	2019	2018
Detyrime për paga punonjësit	2,720,334	1,557,301
Detyrime për Sigurimet Shoqërore e Shëndetsore	899,082	542,663
	<u>3,619,416</u>	<u>2,099,964</u>

16. Të pagueshme për detyrime tatimore

Një detajim i detyrimeve tatimore në datën 31.12.2019 jepet si në tabelën më poshtë. Këto detyrime janë paguar plotësisht në vitin 2020 duke respektuar afatet përkatëse ligjore.

	2019	2018
Detyrim Tatimi në Burim	77,675	18,900
Tatim mbi të ardhurat personale	99,949	57,441
	<u>177,624</u>	<u>76,341</u>

17. Të tjera të pagueshme

Kjo shumë paraqet detyrimeve ndaj ortakëve për financime të shoqërisë të cilat do të shlyehen në të ardhmen.

18. Kapitali dhe Rezervat

Nga veprimtaria e realizuar gjatë vitit 2019 kapitali i RL TEKSTILE SHPK ka pësuar ndryshimet si më poshtë:

	2019	2018
Kapitali i Nënshkruar dhe paguar	10,000	10,000
Rezerva të tjera	0	0
Fitimi i pashpërndarë	(6,185,275)	0
Fitim / Humbja e Vitit	<u>(22,697,686)</u>	<u>(6,185,276)</u>
	<u>(28,872,962)</u>	<u>(6,175,276)</u>

19. Ngjarjet pas përfundimit të periudhës raportuese

Nuk ka ngjarje materiale që nuk mund të rregullohet pas përfundimit të periudhës raportuese, për të cilat do të ishte e nevojshme për të dhënë informacion shpjegues.